



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 549/8 Prot.
04.06.2024

Tiranë, më

V E N D I M

Nr. 178, datë 04 .06. 2024

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, shqyrtoi ankesën nr.76, datë 09.04.2024, e paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, përfaqësuar nga z.S. F³, në cilësinë e Presidentit të Shoqatës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, nga linja e transportit të udhëtarëve ndërqytetase Tiranë-Burrel-Tiranë, me operator të licencuar Shoqëria "Marsoni Al Transport", sh.p.k., me nr. NIPT L62415024Q.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: *Në datë 24.03.2024, ora 9:00 e mëngjesit kanë qenë duke udhëtuar z. S. F, dhe shoqëruesi i tij, nga Tirana në Burrel dhe në momentin e zbritjes rreth orës 11:00, kanë nxjerrë për të paguar biletën e udhëtimit sipas ligjit në vlerën 50%, dhe në dorë ka patur librezën e verbërisë. Shoferi i ka kërkuar vlerën e plotë prej 500 lekë për person, i ka shpjeguar se është i verbër dhe shoqëruesi i ka lexuar nenin 11 të të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar. Shoferi është shprehur se në gjithë qytetin e Burrelit në asnjë nga linjat e transportit publik, nuk njihet librezë e verbërisë.*

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

³ Referuar Librezës së Verbërisë nr. 25980, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror, ankuesi është i verbër Grupi i I-të.

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen masave për eliminimin e pasojave që vijnë nga kjo formë diskriminimi.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, shkronja a) dhe shkronja b), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁴, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, si dhe të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “aftësisë së kufizuar”, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

⁴ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Pala ankuese, pretendon se është diskriminuar si person fizik, lidhur me ngjarjen e datës 24.03.2024, por gjithashtu, në tagrin e përfaqësuesit të Shoqatës, ka pretenduar diskriminim të të gjithë kategorisë së personave të verbër (njohur si të tillë nëpërmjet vërtetimit të KMCAP), nga ana e Shoqërisë, e cila nuk pranon t’u njohë të drejtën e udhëtimit me biletë me gjysëm çmimi, përmes paraqitjes së fotokopjes së Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror ose të Librezës së Verbërisë, lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”.

Bazuar në LMD, pala ankuese: edhe si person fizik, edhe si përfaqësues i Shoqatës “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri gjykon se, në adresimin e kësaj problematike kanë interes legjitim të gjitha organizatat apo subjektet përfaqësuese të personave më aftësi të kufizuara në shikim, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve, gëzon një mbrojtje të veçantë në kuadër të Kreut IV, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Konkretisht në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të po këtij ligji, përcaktohet se:

“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”

Bazuar në nenin 32/1/a/b, të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në kushtet që, pala ankuese nuk kishte mundur që të identifikonte subjektin i cili ofron shërbimin e transportit në linjën Tiranë-Burrel-Tiranë, me të cilën kishte udhëtuar në datën

24.03.2024, datë në të cilën pretendohet se është konsumuar sjellja diskriminuuese, Komisioneri me shkresën nr. 549/2 prot., datë 15.04.2024, i është drejtuar për marrjen e informacionit dhe identifikimin e subjektit i cili ofron këtë shërbim, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Me shkresën nr.7365/1 prot datë 18.04.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimi i kryer në sistemin e-Transport, rezulton se në linjën e rregullt të transportit ndërqytetës Tiranë-Burrel-Tiranë, është licencuar shoqëria "Marsoni AL Transport" shpk , me L62415024Q, mbajtës i licencës nr nr.170, lëshuar në datë 15.08.2022, me afat vlefshmërie deri në datë 14.08.2027”.*

Pas plotësimit të ankesës dhe identifikimit të subjektit, u konstatua se nga pikëpamja formale, ankesa objekt shqyrtimi plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 dhe 334 të LMD. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj, duke ndërmarë hapat e mëposhtme:

1. Me shkresën nr.549/4 prot., datë 24.04.2024, Komisioneri, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Shoqëria "Marsoni AL Transport" shpk , me NIPT L62415024Q, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë. Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Shoqëria "Marsoni AL Transport" shpk , me NIPT L62415024Q me shkresën e datës 29.04.2024⁵, vuri në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: *Me marrjen dijeni të shqetësimit të ngritur nga juaj në lidhje me problemin e një qytetari me aftësi të kufizuar në linjën e transportit të udhëtarëve Tiranë-Burrel-Tiranë nga Shoqëria "Marsoni Al Transport " shpk, u bë analiza e këtij rasti me drejtuesit e automjeteve. Shqetësimi i ngritur nga ana e Shoqatës "Shpresë për të Verbërit" qëndron dhe ky problem ka ndodhur me një nga drejtuesit e automjeteve të Shoqërisë "Marsoni Al Transport" shpk, në datën 24.03.2024 rreth orës 9.00. Sipas drejtuesit të automjetit pretendohet se qytetari me aftësi të kufizuar nuk ka paraqitur asnjë dokument për statusin e invalidit (Librezën e verbërisë siç pretendohet). Gjithësesi, nga ana jonë pavarësisht të këtij pretendimi të drejtuesit të mjetit ne jemi në anën e qytetarit. Drejtuesi i mjetit ka pak ditë që ka filluar punë pranë Shoqërisë "Marsoni Al Transport" shpk, dhe për këtë fakt nuk ka qenë i informuar për trajtimin e udhëtarëve me aftësi të kufizuar. Shoqëria "Marsoni Al Transport" shpk, kërkon ndjesë qytetarit për rastin në fjalë dhe njëkohësisht ti kthejë vlerën e biletës qytetarit në çdo rast të paraqitjes së tij pranë Shoqërisë. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, ju sigurojmë se raste të tilla në linjën e udhëtarëve të licencuar për Shoqërinë "Marsoni Al Transport" shpk, nuk do të përsëriten.*
2. Me shkresën nr.549/6 prot, datë 03.05.2024, Komisioneri i komunikoi me palën ankuese parashtrimet e depozituara nga subjekti kundër të cilit ka paraqitur ankesën.

⁵ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 549/5 prot., datë 30.04.2024.

3. Me mailin e datës 23.05.2024 pala ankuese ka dërguar pranë Komisionerit parashtrimet e veta si mëposhtë: *“Shoqata Kombëtare Shpresë për të Verbërit falenderon për bashkëpunimin Komisionerin kundër diskriminimit dhe mbështetjen që i jep shoqatës në realizimin e objektivave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive për personat me aftësi të kufizuara. Në korrespondencën tuaj për kompaninë "Marsoni Al Transport" shpk, ne vlerësojmë qëndrimin e kësaj kompanie për masat e marra, për të garantuar të drejtat e personave të verbër për të udhëtuar në shërbimet e transportit publik sipas ligjit dhe marrjen e masave nga kjo kompani që në të ardhmen nuk do të ndodhin ngjarje si ajo e ankesës nr. 76, dt. 09.04.2024, pasi ky ishte dhe qëllimi i kësaj ankese. Ju bëjmë me dije se ne si shoqatë do të vazhdojmë të jemi në monitorim të përhershëm për të gjithë shërbimet e transportit publik urban dhe interurban dhe do të denoncojmë çdo rast të shkeljes së lirive dhe të drejtave të personave të verbër që bëhet nga ky shërbim, mbetemi me shpresë që shoqëria " Marsoni Al Transport " shpk, të mos ndodhë përsëri një ngjarje e tillë me personat e verbër”.*

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb dhe pala ankuese nëpërmjet email të datës 23.05.2024, por dhe të komunikimit telefonik me inspektorin e çështjes ka deklaruar se tërhiqet nga ankesa, pasi ka arritur në një zgjidhje me mirëkuptim të problematikës së bashku me subjektin kundër të cilit ka paraqitur ankesën, Shoqërisë "Marsoni AL Transport" shpk , me NIPT L62415024Q.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se, qëllimi për të cilin është filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet: *“Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”*, Komisioneri vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është paraqitur ankesa.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet: *“3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”*

Në nenin 90/3 të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* parashikohet përfundimi i procedurës administrative: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në nenin 94/1, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.*

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr.76 regjistri, datë 09.04.2024, të paraqitur nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, përfaqësuar nga z. S. F, kundër Shoqërisë "Marsoni ALTransport" shpk, me NIPT L62415024Q duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.76, datë 09.04.2024, pa një vendim përfundimtar, për shkak se pala ankuese është tërhequr nga ankesa, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Rekomandohet që Shoqëria e Transportit të udhëtarëve "Marsoni AL Transport" shpk, me NIPT L62415024Q, me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit pa pagesë për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe në kontratat individuale të punës, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria Transportit të udhëtarëve "Marsoni AL Transport" shpk, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA